



## **Procesverbal nga mbledhja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve**

### **Nr. 39**

Datë: 24. 07. 2017, ora: 11:00

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare e KQZ-së

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Betim Gjoshi, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Adnan Rrustemi, Binak Vishaj, Eshref Vishi, Nenad Rikallo, Ercan Spat, Bajram Ljatifi, Ergit Qeli.

SKQZ: Enis Halimi, Krye shëf i SKQZ. Miradije Mavriqi, drejtoreshë e ZRPPC. Përkthyes: Vera Dula.

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi. Përkthyes: Vera Dula

---

## **RENDI I DITËS**

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së
2. Aktivitetet e ZRPP
3. Raport i Këshillave të KQZ-së;

- Këshilli për Operacione Zgjedhore;

- *Shqyrtimi dhe miratimi i Mastër listës dhe kërkesat për Krijimin e QV-ve të reja sipas Komunave për Zgjedhjet Lokale 2017*

- *Shqyrtimi i kërkesave për zëvendësimin/ plotësimin e Anëtarëve të KKZ-ve sipas Subjekteve Politike neper komunat përkatëse;*

-*Shqyrtimi i vendimi për punëtorinë lidhur me mësimet e nxëna për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës 2017*

- Këshilli për Çështje Ligjore

- *Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesave për zëvendësimin e anëtarëve të kuvendeve komunale*

### 3. Të ndryshme

---

#### **1.Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së**

**Valdete Daka:** Vazhdojmë me mbledhjen e 39-të të KQZ-së, me këtë rend ditë të propozuar dhe me një shtesë të cilën e propozoj unë. Ajo është, që të shqyrtohet dhe të merret vendim për një vizitë studimore në Londër, e përkrahur nga Westminster foundation for democracy. Është vizitë studimore që ka të bëjë me financimin e partive politike në Angli dhe praktikën e tyre. Kjo do të ndodhë në muajin shtator, nga 18-21 shtator. Këto bisedime, kanë qenë qysh para zgjedhjeve parlamentare, por na zunë zgjedhjet parlamentare dhe nuk kemi arritur me i realizuar dhe ky projekt është shtyrë për shtator. Shpresoj që në shtator mundemi me realizuar, pasi zgjedhjet lokale janë pak më fleksibile. Nëse pajtoheni me futë edhe këtë në rend dite...?

**Sami Hamiti:** Kryetare, e kemi edhe një zëvendësim, i cili nuk është shqyrtuar në këshillin për çështje ligjore.

**Valdete Daka:** E kemi pikën vetëm e vazhdojmë.

**Enis Halimi:** Faleminderit! Me mirëkuptimin e juaj, propozoj që të diskutohet rreth çështjes që e kemi ngritur në javën e kaluar, në mbledhje, por edhe në mbledhjet e mëparshme, e që ka të bëjë me pagesat e këshillave të vendotimeve. Në kontekst të asaj çka do të bëjmë me komisioner të cilët kanë qenë në ato vendotime kutit e të cilave janë rinumëruar, për shkak se këtu ka pasur ide më herët që të ndjekim politik ndëshkimore në raport me ta që të mos I paguajmë fare. Tashme jemi krejt në fund në finale të ekzekutimit të pagesave dhe është mirë që të merret një vendim se si do të procedojmë me atë kontingjent, bëhet fjalë për rreth 3 mijë komisioner, 2900 e diçka si numër i përgjithshëm. Tashmë listat me disa gabime të vogla i kemi në disponim, i posedojmë ato lista dhe ka mbetur vetëm çështja e këtyre komisionerëve si të vendoset pra, tu ndalet pagesa apo të procedohet më këtë punë. Faleminderit.

**Valdete Daka:** Atëherë kush është për këtë rend dite me këto shtesa? Faleminderit. Vazhdojmë me pikën e parë, ajo është ZRPP-ja. Urdhëro drejtoresh.

**Betim Gjoshi:** Kryetare më fal, ne po i bëjmë disa rregullore me i respektu nuk jemi duke i respektuar. d.m.th., ne asnjë nga këto pikave nuk është në pajtim me rregulloren e punës...

## **2. Aktivitetet e ZRPP**

**Miradije Mavriqi:** Faleminderit kryetare. Të nderuar anëtarë të KQZ-ës, jeni njoftuar me 6 korrik që iniciativa politike e quajtur alternativ me kryesuese Mimoza Kusari kanë aplikuar për regjistrim të partisë politike, është dorëzuar dokumentacioni dhe është shqyrtuar i tërë dokumentacioni duke filluar prej programit statutit deri janë kontrolluar edhe librezat e përkrahësve të votuesve të regjistruar. Ju është dhënë edhe një afat shtesë këtyre 10 ditëve të kontrollimit sa i kemi me ligj, që të plotësoj statutin. Statuti është dorëzuar i plotësuar edhe programi gjithashtu dhe zyra ka publikuar në media edhe në faqen zyrtare të internetit të KQZ-ës në shqyrtim publik në afat prej 7 ditëve. Gjatë këtyre ditëve në zyra ose as në KQZ-ë nuk është dorëzuar ndonjë kundërshtim sa i përket regjistrimit të kësaj partie politike, andaj zyra rekomandon që të regjistroj partin politike e cila do të ishte sipas radhës do të thotë në regjistër me numrin rendor 60. Faleminderit.

**Valdete Daka:** Faleminderit drejtoreshë. A ka dikush diçka me thënë?

**Betim Gjoshi:** Kryetare është e vërtetë që ka ligji d.m.th. siç po e thotë edhe Bajrami i ka paraparë këto çështje kur jemi në periudhë zgjedhore por, besoj që ligji thotë edhe për partitë tjera të gjitha ato që kanë deklaruar që nuk janë të certifikuar, janë të certifikuar por e njihni një procedurë të standarde kështu që nuk mundet me garuar as kjo as tjerat si koalicion, mund mos me garuar fare në zgjedhje.

**Valdete Daka:** Atëherë nëse nuk kemi diskutime, kush është për regjistrimin e këtij subjekti politik?

Anëtarët e KQZ, miratuan rekomandimin e ZRPP për regjistrimin e subjektit politik “Alternativa”.

## **3. Këshilli për Operacione Zgjedhore**

*1. Shqyrtimi dhe miratimi i Mastër listës dhe kërkesat për Krijimin e QV-ve të reja sipas Komunave për Zgjedhjet Lokale 2017*

**Adnan Rrustemi:** Po e konsiderojmë Mater Lista si informacion përfshinë listën e të gjitha qendrave vendvotimit në Kosovë. Është një obligim ligjor për ta publikuar në afat të caktuar por, përse është e ndërlikuar me këtë pjesën që po e prezantoj si rekomandim të këshillit të operacioneve zgjedhore që ne e kemi pasur një numër të kërkesave për themelimin e qendrave të reja të votimit, miratimi i të cilave duhet të integroj ose i përfshijë në listën e tërësishme të qendrave të votimit e që duhet të bëhet publike për të gjitha palët e veçmas për votuesit. Një ndër këshillat e operacioneve zgjedhore kemi shqyrtuar një numër të caktuar të kërkesave për

themelimin e qendrave të votimit, që kanë ardhur përgjithësisht nga subjektet politike. Si këshilli i operacioneve zgjedhore e konsiderojmë që i plotësojnë kriteret e parapara me ligj e me rregullin e përcaktuar, kështu që e rekomandojmë Komisionin Qendror të Zgjedhjeve që si të tilla ti miratoj dhe ti përfshijë në regjistrin qendrave të votimit. Natyrisht që një qendër e kemi miratuar në parim që të plotësohemi me informacione dhe po e shoh që janë dhënë informacionet shtesë, kështu që sa për informacion janë 14 qendra të reja të votimit që po dalin nga lista. Kështu që e rekomandojmë KQZ-ën që ti miratoj.

**Eshref Vishaj:** Unë e kam një propozim, që para nënshkrimit të këtij vendimi në pikën 1 paragrafi 1 të shtohet edhe numri që e përmendi Adnani numri 14, për arsye se thuhet, të miratohet krijimi i qendrave të votimit për zgjedhjet lokale 2017 pra, fjala është për 14 ndërsa pika 2 e ka pjesë përbërëse listën.

**Betim Gjoshi:** Unë kam edhe diçka tjetër, edhe prita që na kanë sjell ndonjë shkresë. Ne kemi biseduar edhe për mbylljen e disa qendrave edhe ajo është dashur të ketë vendim. Të paktën për dy më kujtohet që kemi marr qëndrim që ti rekomandojmë KQZ-ës , se nuk i kemi hapur asnjë herë në histori të vet, njëra ka qenë në Mitrovicë të jugut, njëra ka qenë në Prizren, faktikisht në Prizren na thanë që janë 2 kështu që po i bije 3 qendra, nuk ekzistojnë banorë më kryetare, ne kemi pasur qendra që nuk ka asnjë banor që po i dërgojmë ekipet mobile. Ka qenë ideja d.m.th. edhe pat mbetur që të na sjellin me shkrim këto që po i flasim tash edhe për bashkime edhe për ndarje edhe për shuarje por, nuk i kemi të plota, tash nuk po di a me vepruar me besa a si me ja bo kësaj pune.

**Adnan Rustemi:** Në këshillin e Operacioneve zgjedhore, sepse pika e rendit të ditës edhe në këshill edhe KQZ ka qenë gabimisht e formuluar, sepse janë dy çështje brenda një pike. Themelimi i qendrave të reja të votimit është çështje e ndarë prej miratimit të Master Listës, dhe vetëm pasi të themelohen këto miratohet si tërësi. Ne e kemi pasur në këshill edhe Master Listën edhe themelimin. Për fat të keq po mungon Master Lista. Sikur ta kishim pasur, së paku në mënyrë të tërthortë e kishim ditë që po i largojmë dy, se po i miratojmë minus dy qendra të votimit. Është e vërtetë ajo që tha Betimi. Ne kemi pasur vlerësim nga sekretariati që duhet u larguar, sepse nuk ekzistojnë më. Tash, le ta diskutojmë si po e procedojmë. Nëse nuk gaboj është një afat i shpejtë që duhet me u publikuar kjo lista totale e qendrave të votimit. Unë iu rekomandoj që me miratuar themelimin e këtyre 14 qendrave të votimit dhe pastaj diskutojmë mbylljen.

**Betim Gjoshi:** Nuk ka çka me dhanë zgjidhje askush. Le ta sjellin deri në fund të mbledhjes numrin e qendrave të votimit që po mbesin, në Master Listë numrin që po largojmë edhe e shtyjmë këtë pikë. Po i miratojmë këto të reja, pjesën plotësuese le të na sjellin.

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë rekomandim të KQZ-it

*2.Shqyrtimi i kërkesave për zëvendësimin/ plotësimin e Anëtarëve të KKZ-ve sipas Subjekteve Politike neper komunat përkatëse*

**Adnan Rrustemi:** Informacioni që kemi marrë ka qenë vlerësim edhe i mëparshëm për mundësin e themelimit po tash na pe dina qysh i kemi KKZ-të ata kanë një far interpretimi të ngusht për të ligji kur bëhet fjalë për themelim të qendrave të votimit diku nuk dojnë me i shtu vetës punë, diku e konsideroni që e kanë ma të vështirë, por mirë është janë të bazuara. Këshilli i operacioneve zgjedhore ka trajtuar edhe disa kërkesa të disa subjekteve politike për zëvendësimin, respektivisht plotësimin e anëtarëve të KKZ-së. Bëhet fjalë për Deçanin, Ferizajin, Vitinë dhe Vushtrinë nga subjekti politik Nisma, në Zubin Potok nga SLS dhe Mamushë nga PDK. E rekomandojmë KQZ-në që t'i miratoj këto plotësime, respektivisht zëvendësime të anëtarëve të KKZ-së për 6 komuna.

**Valdete Daka:** Vetëm po zëvendësohen dhe një plotësim. Mirë. Kush është për? Faleminderit!

*Komisioni miratoi plotësimin, respektivisht zëvendësimin e gjashtë anëtarëve të KKZ-së.*

**Betim Gjoshi:** Kryetare, vetëm një plotësim sa për procesverbal. Unë kam pranuar një shkresë të premtën që dy nga anëtarët e KKZ-ve që i kemi emruar në komunën e Drenasit kanë procedim penal në bazë të një kallëzimi tonë penal, në lidhje me një libër që ka humbur në 2016 në zgjedhje. Nëse është e vërtetë, njëmend kemi bërë gabim. Si informacion mundem me ia ofruar. Unë kam pranuar shqetësim. Çdo herë ai që është i asaj ane më shume meret me këtë punë. Unë e di që ka pasur një deklaram që nuk është mirë me emruar KKZ-në e Drenasit, sepse nuk ka qenë e përgjegjshme në punë, por unë nuk mundem me votuar për ose kundër. Nëse ka procedim të tillë, nuk është mirë me kërkuar prej partive me i zëvendësuar, nëse nuk ka asgjë. Desha ta ngris si shqetësim.

**Valdete Daka:** Nese kemi bërë kallëzim ne, është lehtë me u zbuluar...!

**Enis Halimi:** Unë këtë informacion nuk e kam. Nëse ke mundësi me na përcjellë, do ta shikojmë. Nuk po di për çka po bëhet fjalë.

**Sami Hamiti:** Në rregull. Duhet me iu thanë atyre automatikisht me i zëvendësuar...!

*3.Shqyrtimi i vendimi për punëtorinë lidhur me mësimet e nxëna për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës 2017*

**Adnan Rrustemi:** Po e shoh një pikë të rendit të ditës të këshillit për operacione zgjedhore, por ne nuk e kemi trajtuar në këshill të operacioneve zgjedhore as agjendën, as projektin e as vendimin. Kemi kërkuar me u proceduar direkt në KQZ sepse e kemi konsideruar të vonshëm.

**Betim Gjoshi:** Unë nuk e di tash. Prap këtu, ndoshta pa qëllim, por një diversion. Ne i tham sjellne, sepse KQZ e ka marrë një vendim për puntorinë (për 26 persona). I kemi thënë sjellne ta plotësojmë, ta shtojmë numrin në bazë të agjendës. Tash prap po mbetet *shqyrtim i vendimit të puntorisë lidhur me mësimet e nxëna është*. Ndoshta është plotësim i vendimit për punëtori, është dashur të jetë. Dhe e kisha lutur Xhemen, që pas takimit, dy minuta me u ndalë rreth organizimit të nesërm të shkuarjes me biseduar, sepse me thanë që je person teknik, për me i organizuar.

**Valdete Daka:** Kryeshef, a bën me na treguar arsyetimin?

**Enis Halimi:** Ditën kur e kemi pasur certifikimin, edhe më herët ka pasur ide, por edhe atë ditë është formalizuar me një vendim të KQZ-së për ta organizuar një punëtori. Është dhënë një numër prej 26 personave pjesëmarrës në punëtori. Pastaj e kemi bër edhe projektin dhe e kemi zgjedhur një rrugë në të cilën zgjedhë që të bejmë në kuadër të asaj punëtore edhe prezantime sa më në detaje, prej bartësve të secilit aktivitet në sekretariat gjatë periudhës së zgjedhjeve. Kjo ka tërhequ apo ka shpie në atë situatë ku ne e kemi parë që ai numër i përcaktuar është i ngushtë për formatin në të cilin ne kemi vendosur që ta hartojmë këtë aktivitet në formë të projektit. Për këtë fakt, është edhe një herë e sjellim para jush që të shqyrtojmë, eventualisht me miratimin e juaj edhe të zgjerohet edhe ai numër i cili ka qenë i vendosur. Një vendim i cili është marrë nga kryeshefi ekzekutiv në lidhje me implementimin e atij vendimi të KQZ-së, është anuluar ai vendim në ditën e premtë, kështu që tash jemi pa vendimmarrje sa i përket kësaj çështje.

**Valdete Daka:** Me përkthyer shqip d.m.th. që i kanë shtuar 5 persona, e ne duhet me miratuar me mbuluar. Kjo është. Në të vërtetë kanë qenë të shtuar 11, por pasi e kemi parë agjendën e kemi parë që shumica e atyre që janë shtuar nuk kanë as me prezantuar as nuk janë bartës të projekteve.

**Adnan Rrustemi:** Ne kemi pasur vërejtje gjithmonë për këtë praktikë, por ne e kemi pranuar një vendim. Personalisht, sa do që jam për me kundërshtuar këtë qasje. Qasja është shumë antiligjore, përveç që është edhe e pandershme. E bën projektin, nuk e miraton KQZ. E bën agjenën, nuk e miraton KQZ. E merr vendimin, nuk e miraton KQZ. edhe atë me një kundërshtim në orientim të KQZ-së që ka thënë, praktikisht, në parim 26, dhe në fund na dërgohet ne email vendimi dhe na thuhet që u shfuqizua vendimi me një tjetër. Në çfarëdo rasti me marrë një vendim tjetër duke i përjashtuar njerëzit është shumë e dëmshme nga KQZ. Unë jam për me formalizuar atë vendimin, por me këto vërejtje, që nuk është në rregull kështu me na trajtuar.

**Enis Halimi:**u Vendimi kur është marrë i kryeshefit ekzekutiv ka pas të bëjë me këta emra, pra nuk është heq askush nga lista, 31 ka qenë të parapame të kryeshefit ekzekutiv kur është konstatu shkarja mes 26 dhe 31 është anulë vendimi edhe tash jemi te 31.

**Ercan Spat:** Faleminderit kryetare, ju faleminderit kryetare për përkthimin e juaj në gjuhën shqipe po unë e kom vështir me kuptu prandaj e kam një pyetje, pom doket se në këtë çështje tash një element shumë i rendsishëm është financimi, kur jemi të vetëdijshëm të organizimi është në

financimin e OSB-së unë pom intereson a dinë dikush më na përkthi se qka po mendon OSB-ja për këtë çështje na shumë lehtë po mundemi me i ngrit dy gishta faleminderit.

**Valdete Daka:** E në faktë OSB-ja është gjetë para një akti ku janë dakordu edhe pse ka tejkalu ata qka kemi kërku prej tyne se na kur e kemi dërgu kërkesen na e kemi dergu për 26 vetë edhe më një orientim të një draftagjende mirëpo në ndërkohë u ndryshu, tash ata e kanë pranë atë ndryshim po mu mu ka duft shumë pozitivë e keqe me i shtu emrat përkundër asaj që vendimi i KQZ-së ka qenë shumë i qartë që 26 persona, mandej me qarkullu listat nëpër KQZ edhe mem thirr mu në telefon personat e caktum edhe mem pyt edhe mem kërku llogari pse me hjek e pse me e qit prej listës, publikisht po them se, është hera e fundit që dikush mundet me thirr në telefon mu edhe me than ti mke hjek pse mke hjek prej liste, e as kom hjek e as kom qit prej listave na e kena caktu numrin e 26 edhe ja kina lan kryeshefit me i zgjedh ata të cilët kanë me qenë nga sekretariati edhe veq kur e kom pa numrin 35 fillimishtë, kom kërku që ky numër mu reduku edhe mu qit personat që bile i kanë prezantimet që me arsytë atë shumjje atje edhe ka ardh numrin 31 me qyk të zorit edhe mandej këto lista kanë qarkullu edhe një herë po e them nuk është as e ndershme e as nuk është në rregull që listat me qarkullu hala pa marr vendim KQZ-ja vërtet KQZ-ja ka marr vendim ama aj vendim u ndryshu në mënyre arbitrare nga sekretariati edhe mandej është kërkuar prej meje me nënshkruar qatë vendim për 35 persona çka unë nuk kom dashtë me nënshkru që se smuj me ndryshu vendimin e vete të cilin e ka marr KQZ-ja po kjo është sa për informat edhe për përkthim tash edhe ma të fell shqip-shqip, kjo është krejt qajo që ka ndodh edhe unë besoj që është hera e fundit që na bëjmë diskutime jo parimore edhe jo të bukur, po kur të themi 26 ka trajnime e ka tryeza pune të cilat mundem me u përfshi të gjithë edhe ata persona të cilët duhen me shku, dhe mos të kuptohet kjo si shëtitje në Tiran .

**Betim Gjoshi:** E para sa i përket kësaj çështje konkrete unë pa pas si kërkes të kuart qka po don me marr sekretariati vendim nuk marr se kemi marr vendim rreth kësaj çështje në qoftë se duhet me marr vendim na, duhet me na drejtu kuart sot bile të paktën me gojë mbase jemi në momentin e fundit çka po don me ba, masnej kemi me marr një vendim me shku në Shqipëri me financim të OSBE-ës, për 26 persona qofte kanë ndnjë kërkesë tjetër le të na drejtohen sot na e marrim vendimin jam i gatshëm. Unë çka mendoj në thelb se KQZ edhe këshillet e KQZ-së nuk jemi duke e marr seriozisht nga sekretariati i Komisionit Qendror Zgjedhor aspak seriozisht, minimalisht seriozisht bile është duke u pritur me entuziazëm kur po largohemi ndonjë pjesë e jona që kontribojmë në këtë instucion më së shumti, ma shpejt prej këtij instucioni për me ardh të tjerë që munden ndonjë dit me manipuluar. Kjo ka të bëjë më së pari për sende elementare, na në këshill të operacioneve zgjedhore ju kemi than saktë bina për qendra të votimit shpjegimin për atë që po hiqen dhe po shtohen, ju kemi thënë bina një shkresë sa i përket KKZ-ve që po i zëvendësojmë dhe që i zëvendësuam parzit bina saktë me shkrime ky zëvendësohet për këtë, është vendi i lirë, këtu jetw i lirë. Këtu ka ardhur një shkresë e një subjekti tjetër që qoftë se edhe për të nuk ka pasur ndonjë gatishmëri, çka po dua me thanë problemin më të madhin e kemi këtu në mbledhje, kjo nuk është hera e fundit kryetare garantoj d.m.th., nuk jem tu i vet na , na jena tu i ligjsu veprimet e tyne , shyqyr qe ste kokan dy prej tyneve edhe kom than që as prezantimet

nuk janë ato qysh është dasht me kanë me një punëtori për mësim të nxana për zgjedhje pe zam që auditori , ky munet me ardh në punëtori edhe është i mirëseardhur nuk ka bre qka me fol auditori as nuk ka qka me bo ne prezentim ne kohën e zgjedhjeve me emen i kom than në këshill dmth me emën, këtu problemi është qe ktu po blehet paq , ne këtë institucion është gjetur bleja paq gjuaja KQZ-ës, le të del KQZ-ja e keqe, le të priset me njerëz nuk ka filtrim. Neve na ka ardhur nga 15 vet të KKZ-ë të propozuara, pse hiq KKZ-ja, thirr KKZ-ja në telefon pse mhjeke. Adnani na ka treguar një shembull, bile kishte qenë i ditur se edhe rezultatet i ka lexuar Adnani, se nuk po na vijin teknikisht të përgaditura e ne po duhet të kryejm punën e shërbimin në këtë rast të sekretariatit, se është shërbim sekretariati nuk po e kupton këtë rol, realisht vendimmarrësi. Cilat punë po don sekretariati po kryhen, cilat nuk don kot e ke, edhe nëse merr vendim ti nuk kryhen ose nëse shpreh qëndrim nuk kryhen, edhe nisa ka pajtim të 100% të KQZ-ës nuk kryhen. Pra, është devaluuar roli i sekretariatit karshi Komisionit Qëndror Zgjedhor është në pikën më kritike në 10 vitet e fundit, ka mospërfillje totale ndaj Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Unë sa të jemë këtu kam me u mundu të sillem njejtë si jam sjellur para 10 viteve, si sillem sot. Me ndonjë kërkesë mirësjellje jam në gjendje të toleroj shumë deri sa nuk shkelet ligji, por, me përbuzje nuk e lejoj askënd. Unë e kam pasur një kërkesë minimale përnjë ditë me lëviz këtë punëtorie nuk ka pasur mirëkutim.

Edhe për këtë ja kemi bërë të qartë në këshill, tha z. Gjoshi. I kemi thënë ta sjell kërkesën me shtu, dy gjëra i kemi thënë duhet të jenë. Me shtu kerkesën edhe qka ka obligime financiare duhet të merren vendimin d.m.th. që të mos i ngarkojmë ata, se dhe pse 99% e financon OSBE-ja ka një implikim financiar për Komisionin Qendror Zgjedhor dhe për këtë duhet një vendimmarrje, thash me mirëkutim mund të ulemi me kërku a ma kryni këtë favor po, por, nuk mund të flasim përmendësh.

Këtë listë e kanë që një javë ditë institucioni që të ka financiar, është bërë rezervimi për ta, d.m.th. a ka gjë më të rënd, neve na dërgohet vendimi 3 ditë përpara në e-mail 4 na dërgohet programi, agjenda të gjitha pastaj pas 3-4 dite atë që e kemi miratuar ne ta ligjësojmë. Por, jo se ka njëfarë mirëkuptimi, pa asnjë kërkesë falje në fillim, me thon që më falini se ka ndodhur nuk kemi dashur të ju pengojmë vetëm njëfar mirëkuptimi me një keqardhje, njeriu e kalon kemi kaluar raste edhe më të rënda. Në qoftëse nuk ka një kërkesë të gjartë të tyre unë nuk votoj për d.m.th. kjo është individuale.

**Valdete Daka:** Sa për rezervim, rezervimi anulohet nuk është paguar asgjë, rezervimi anulohet. Në qoftëse ne konsiderojmë që nuk është e domosdoshme me shku numri përtej asaj qka ne kemi vendosur. E sekretariati le të vendos kush shkon e kush nuk shkon. Kjo është shumë e thjesht.

**Enis Halimi:** Vendimi është e vërtetë që është marr për 26 vet. Vendimi është marr në kushtet kur ne ende nuk kemi pasur projekt për një gjë të till, kur e kemi bërë projektin për një gjë të till ka reflektuar ose është ndjerë si imanenc që duhet me rrit numrin në mënyrë që me pas prezantime sa më detaje prej të gjithë bartësve të tyre. E kemi dakordu në katër, pesë takime me



perfaqësuesit e OSBE-së, ndoshta është shkarje e jona ose munges e koshiençës tonë për ta procedu ndoshta me kohë, por agjendën përkatësisht projektin e kemi procedu tek adresat e juaj elektronike, është ndoshta një lëshim që nuk e kemi formalizu më tepër se sa që duhet për shkakë të rrethanav nuk kemi mundur gjatë dy jave të kaluare për shkakë të rrethanave të njohura. E kemi procedu dhe agjenda si e tille e detajshme me prezantime detale tërheq këtë numër të pjesmarrsve, po që se nuk ka gadishmëri për ta rrit numrin ne e riformatojm agjendën e kthejm në atë numër e cila e garanton minimumin e një përfaqësimi, pra e bëmjë një rishikim të asaj agjende, po megjithatë ne ju lusim që ta miratoni këtë projekt që tërheq pas vete këtë implikim që ka të bëjë me rritje të numrit.

**Betim Gjoshi:** E para, vlerësimin e bën KQZ. Nëse e bëni një projekt, është rregullorja e punës. E miraton këshilli, e miraton KQZ-ja. Pastaj i dërgohet palëve të tjera dhe bëhet vlerësimi a ka nevojë, apo jo me u shtuar. Ne mundemi me menduar që dikush tjetër, me prezantuar. Nuk është vlerësim i yti. E dyta, prap po tham nuk po e bën kërkesën e qartë. Askush nuk tha që jemi të gatshëm me rritë numrin. Mos i keqpërdor fjalët e tjerëve, por bëje kërkesën e qartë. Thuaj, ne në emër të sekretariatit të KQZ-së, kërkoj me rritë numrin për kaq. Nëse do me japë arsyeji jep, a qëndron apo nuk qëndron është qështje e vendim marrjes sonë, bënu pak më serioz.

**Adnan Rrustemi:** KQZ-ja nuk e ka miratuar projektin, është e vertet që e kemi pasur në imell, une edhe mundem me I kuptu pse nuk e kemi miratu edhe ka ndodh pakë shpejt e shpejtë. Inicjativa edhe data edhe krejt por nuk është që ska pasur mundësi që nuk është mbajte një mbledhje për me e miratuar. Prioritet ose si me thanë vlersimet për rëndesin e temave ose si me thanë prezantimeve dhe të prezatuesve I ka percaktu sekretariati dhe nuk I kemi percaktu ne, rrjedhimisht edhe njerzit thuajse i ka percaktu nëse jo formalisht në mënyr të tërthort që i kan percaktu këta une jamë për me lanë në nivel të vendimit të kryeshefit për të gjith pjesë marrësit e sekretariatit nuk du me marr vendim as për me rrit as per me e zvoglu

**Valdete Daka:** E kemi një vendim i cili egziston ku kemi thanë 26 vetë secili, une e kamë nënshkruar edhe është protokolluar...

**Adnan Rrustemi:** Nuk po du unë me u lshu në nivel të diskutimeve se une mendojë se me atë 26 edhe qikjo agjendë, ishte implementu edhe qikjo agjendë sa do që kit agjend kishim mujtë për me e ndryshu se nuk jamë kundër për mos e u keqkuptu tjetër sen është pjesmarrja e individëve të cilët jan të caktum dhe tjetër senë është prezantimi unë mundem me u pajtu që me marr pjesë. Te auditimi se munden me diskutu nga kënd vështrimi i këtyre procedurave sa na kanë shërbyer me pengesa të sajohet etj etj, ose sa janë respektu por a është prioritet me ndëgju një prezantim për procedurat e prokorimit dhe të auditimit në kët fazë edhe në kontekstin e prezantimit të nxana nuk ka prioritet a kontributin si pjesëmarrës. Po munden me e bo madje edhe një prezantim tjetër po e marr si shembull për bazën ligjore. Të procesit zgjedhorë a është prioritet , për mua nuk është prioritet na krejt e dijmë ligjin qaq sa e dijm dikush ma shumë, dhe dikush ma pakë i dijna cilat janë operacionet dhe aktivitetet ideja u kanë edhe këtu e kemi thanë pak a shum edhe në qfar mënyre e kemi thanë një mënyrë ma të drejtë për drejtë. Një vëretje për prezantimin aj e ka

pas për brengen për mos me bo “ horë” po e praparazojë përpara ndërkombëtarëve por une po e thomë ndryshe nuk është ideja e që është e të bonit horë. Qështja është me e pa tryezën puntorin në kontekstë të mësimëve të nxana , qka ka shkuar diqka jo si duhet dhe qka mundet për me u marrë mësim po e marrë një shembull dhe po e marrë edhe at ditë. Nga votimi dhe regjistrimi i votimit të jashtë vendit dy gjana në procesin e që mësova që i keni përfshi janë inovacione të vogla p.sh , imelli me u kthy automatik përgjigja se kush ka dërguar aplikacionë që mos me pasur nevojë, disa here tek i njëjti me i dërgu duke mos e ditur a i ka ardhë a jo dmth shumë mir qe e ka bër këta teknologjia kjo kursen që mos met ardh disa here i njëjti imell edhe po e zë qikjo është ideja e mësimëve nuk është vetëm ideja e ligjit apo e normave dhe rregullave se na nashta i kemi të mira rregullat dhe ligjet. Madej mendojë se nuk janë zbatuar ndonjë here edhe siq duhet problemi dmth është me e pa në qit kontekst nuk janë as temat e prezantimit e as prezantuesit por tash se qka kanë mujtë me bo tashë. Në këtë fazë që nuk jamë shum i sigurtë duhet me e pa pakë në auto kritikë kit punë dmth nuk është se na jemi mrena duke e diskutu se na me i qitë në publikë aty edhe me ja thanë vetës në kët rastë se kena bo qaq ose e kemi bo shum mir ose mundet me e bo ma mirë, nuk është asgjë edhe me ja thanë prap njëri tjetrit nuk është asgjë jemi duke e mbajtur, për me i mbajt ose me i mësuar mësimet nga një proces për me e permisu tashë une nuk e di se qka mujna me bo për me e dhan propozimin konkret nga kryeshefi se qka po kërkojmë me qenëse prap po kërkojmë jamë me gjith vëretjet për me formalizu qat vendimin, që e kanë marr një here

**Valdete Daka:** Mendësia tek menangjmenti është gjithmonë. Rregull se veq menangjmenti që duhet me kërku është e gabushme qasja është e gabushme, ka trajnime ka tryeza ku një segment i sekretariatit , ka ndonjë tryez se nuk ka edhe qka me prezantu edhe nuk është e domesdoshme,

**Betim Gjoshi:** Kryetare a banë si KQZ ma e lehta si me thanë e menagjmentit te kryeshefi por jan ngushtë edhe po e dijnë dhe po thojnë hajde fol se nuk po dojnë vet me u futë. Duartë ne zjem edhe nuk po dojnë këtu është problemi edhe po thojnë hajde ti po thot fol i 3 atje ja spe marrin diqka nga proceset zgjedhore hajde fol ti diqka për diaspor të sherbimit votues ska nevojë me folë duhet me ditë operacionin edhe natën këtu është problemi se me pas dashtë për me e prezantu , për krejt segmentet vet ju kish ra në ball krejt kritikate hajde te flasë edhe ti futë në sistemi zgjedhorë sa ma shumë tema qërjetohet muhabeti se nuk mundesh me u përqendru tek pikat kryesore që janë edhe qishtut shkonë kjo far pune por na . Sjemi për me e diskutu sod se unë i kam thën e kam filluar at ditë dhe më kan mbështetu, Samia. Adnani e të tjerë, mos boni prezantime për me na treguar si është departamenti dhe me qka mirret departamenti por ne i kemi mësuar që 10 vite ja nuk i kemi mësuar asgjë. Por ju kemi thanë se qka duhet me marr nga këto mësim për me marr na mësim ma mirë. Se qka është bër mir në këto që me apliku edhe në tjera sene, ose në tjera zgjedhje qka keni pa defekt se qëllimi dmth i këtyre ose i krejt tjerave ose pse jena ngut ose me thanë pse keni emplimentu zgjedhje lokale për mu ma interesant u kanë për me qenë një studim ma i plotë po e marr si shembull për, fletë votimet e pa vlefshme e kemi thanë edhe në kshill të operacioneve zgjedhore se sa diqka tjetër disa fakte që mundesh me i vërtetu që jan ne difekt që smujna me i ndërru na se na nuk mujna me e ndrru ligjin për prokurim as ligjin e

auditimit e as ligjin e financav publike që mujna me ndrru ose në qito pun që i kemi në kuadër të kompetencave dytësore që i kemi të procedurave tona , të mbrendshme por hajdeni ta bëjmë propozimin konkret mos të vazhdojmë më tutje se i kemi me i qertifiku

**Adnan Rrustemi:** I pa kuptimë është diskutimi ose një afat ose një prezantim

**Binak Vishi:** Kryetare nuk është hera e parë që organizojmë kësi teori për prezantime,kemi thanë herav tjera me organizu por skemi pasur proces zgjedhorë e kemi pasur vitin tjetër e kemi bo ma,dmth kemi qenë ma të kompletuar edhe ma komodë. Edhe në pregaditjet e materialeve jemi zgjënuar ma shumë në tema tashë për shkakë se i kemi zgjedhjet lokale ne detyrohemi të përmbahemi vetem në ato tema që kan me u bo në operacjone zgjedhore duke fillu prej,votimit jashtë vendit dmth të gjith kemi japur kritikrat deri te procedura e QNR-s edhe në raportin e vëzhgimit të. Vëzhguesëve të Bashkimit Evropian, që i ka jap disa gjetje që është mir edhe na me i trajtu në këtë raportë kështu që ne rastë se ka dalje se në zgjedhje që janë mundesit për me i emplimentu, në bazë të zgjedhjeve me implementu ne zgjedhjet lokale ti tejkalojmë këto që jan jashtë kësaj fushe edhe të jesin në vendimin e parë ku janë edhe 26 shkaktarë, pjesëmarrës tema që kan me bo naj zgjedhje qoftë prej procesit jashtë vendit qoftë edhe tek numri i vendë votimeve që pritet me u kan edhe hala ma shum i pa vlefshëm në këto zgjedhje ku ka ngecë KQZ-ja , ku ka deshtu dhe cilat janë ato situata që na e mendojmë se është se na duhet me i bo ma mir apo strategjia. Te procedurat e QNR-së ka plot sene që na munet me i bo se na qka duhet me i bo në pjesën tjetër se që jan kan na ose që i bajnë në situat tjetër ose në masë , zgjedhjeve lokale.

**Enis Halimi:** Kryetare emra nuk kemi përmen prej 26 e tani me thanë plus plus na kemi fillu mbasë marrjes së vendimit që kemi fillu me e bo projektin i cili e kemi në Gmail. E kemi pa se projekti na ka bër me një situatë ku kërkohet një rritje e numrit të prezantimeve për me i mbulu të gjitha dimenzjonet e punëve dhe atë prej zyrtarëve pëergjegjës kjo ka shku deri tek numri 31,që parashifet edhe një here me projektin edhe një here që tashmë i keni në adresat e juaja. Pra ideja është që ta miratojmë kët projektë që i terhjek 31 e jo 26 këerkon pjesëmarrjen e 31 duke pëerfshirë shëerbimet mbështetëse,

**Betim Gjoshi:** Kryetare une po mendojë se kryeshefi po fillonë me lujtë me neve por edhe kjo gracka që na me hjekë njerzë ma i hjekë , na saktë i kemi caktuar 26 veta në bazë të provojës së kaluar 26 veta projekti u kan edhe herave të kaluar nuk kemi zbuluar një projektë ku është marr copy past prej të njejtit që është qenë duke ju shtuar numri i prezantimeve që kan mujtë me qenë sipas tyre të arsyeshme nashta as tashë por nuk na kan pru për me e arsytu diqka po e dyta na jemi ardhë neser kur të vjen auditori në qofse e shef që na e kemi marr vendim 12 orë para se me u nisë është jo serjoziteti ma i madhi krejt qka mujna me marr vendim as projektë e as agjendë se

